VENDIM
Nr.9, datë 26.2.2007

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i	Gjykatës Kushtetuese	
Alfred Karamuço	Anëtar i	“	“
Fehmi Abdiu	Anëtar i	“	“
Kristofor Peçi	Anëtar i	“	“
Vjollca Meçaj	Anëtare e	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“	“
Petrit Plloçi	Anëtar i	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar i	“	“
Kujtim Puto	Anëtar i	“	“

me sekretare Brunilda Bara, në datat 11.7.2006 dhe 19.7.2006, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.30/1 Akti, që i përket:

KËRKUES: SHOQATA KOMBËTARE E USHTARAKËVE NË REZERVË TË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga kryetari Zyhdi Kroi dhe avokati Ridvan Shkëmbi, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Idar Bistri dhe Riçard Marku, me autorizim.

2. KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Avokati i Shtetit, Kadri Skera, me autorizim.

3. MINISTRIA E MBROJTJES E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Ndue Marku e Rezart Tërshana, me autorizim.

4. INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE, përfaqësuar nga Mirela Selita, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën i neneve 1, 2 (pikat 5 e 6), 7 (shkronjat “a”, “b”) e 9 të ligjit nr.9481, datë 16.2.2006 “Për disa ndryshime në ligjin nr.9418, datë 20.5.2005 “Për sigurimet shoqërore suplementare të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e neneve të mësipërme:

- Të drejtat që u janë njohur ushtarakëve me ligjin nr.9210, datë 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” dhe me ligjin nr.9418, datë 20.5.2005 “Për sigurimet shoqërore suplementare të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, nuk mund të mohohen, të pakësohen ose të ndryshohen në disfavor të një kategorie ushtarakësh, nëse ky diferencim në trajtim nuk justifikohet me argumente bindëse e objektive e nuk përligjet nga një qëllim i ligjshëm.

- Dispozitat ligjore të neneve 1, 7 e 9 të ligjit objekt shqyrtimi kanë mohuar të drejtat që janë njohur e fituar me ligjin e mëparshëm pa argumentim bindës e objektiv dhe pa u diktuar nga një interes publik i qenësishëm.

- Diferencimet në përfitimet e ushtarakëve nuk mund të kenë si kriter daljen në pension para apo pas miratimit të ligjit për statusin e ushtarakut, por ato duhen bërë nëpërmjet llogaritjes së përfitimit sipas elementeve të tilla siç janë mosha dhe paga referuese, paga mujore për gradë etj., siç e parashikojnë nenet 7 e 8, të pandryshuara, të ligjit nr.9418, datë 20.5.2005.

- Neni 1 i ligjit objekt shqyrtimi, duke ndryshuar nenin 13 të ligjit nr.9418, datë 20.5.2005, i rikthen ushtarakët te përfitimet e pensionit të parakohshëm sipas përcaktimeve të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996, pa mbajtur parasysh faktin që neni 33 i ligjit të vitit 2005 (i pacenuar nga ndryshimet që atakohen) ka përcaktuar që ligji i vitit 1996 nuk do të zbatohet për ushtarakët e Forcave të Armatosura.

- Ndërprerja e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, në rastin e punësimit të ushtarakut në rezervë apo lirim, nuk mund të përligjet me “interes publik”.

- Neni 7 i ligjit objekt shqyrtimi jo vetëm cenon një të drejtë të fituar me ligjin e mëparshëm, por bën edhe diskriminim, sepse një kategorie u derdhet kontributi mbi bazën e pagës referuese, ndërsa kategorisë tjetër mbi bazën e pagës minimale në shkallë vendi.

Përfaqësuesit e subjekteve të interesuara kanë parashtruar:

- Ndryshimet e bëra në ligjin për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve janë në përputhje me kërkesat e nenit 17 të Kushtetutës, sepse janë bërë me ligj të posaçëm dhe për një interes publik madhor

siç është integrimi në Bashkimin Europian e NATO. Interesi publik, në elementet thelbësore të tij, merr përparësi edhe ndaj parimit të sigurisë juridike.

- Argumentimi i kërkuesit se treguesi kohor nuk mund të shërbejë si pikë referimi për llogaritjen e pensionit përbën gjë të gjykuar, sepse kësaj çështje i është dhënë përgjigje me vendimin nr.43, viti 1997 të Gjykatës Kushtetuese.

- Shqyrtimi i papajtueshmërisë së ligjit të vitit 2006 për sigurimet shoqërore të ushtarakëve me ligjin nr.9210, datë 23.3.2004 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", nuk hyn në rrethin e kompetencave të Gjykatës Kushtetuese.

- E drejta e përfitimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi nuk bën pjesë në rrethin e të drejtave e lirive themelore, prandaj pretendimet e kërkuesit nuk gjejnë mbështetje në nenin 17 të Kushtetutës. Është në diskrecionin e qeverisë për të rregulluar raporte të qenësishme në varësi të gjendjes së buxhetit.

- Nuk ka asnjë kundërshti midis ligjit objekt shqyrtimi, nenit 33 të ligjit nr.9418, datë 20.5.2005 dhe ligjit nr.8087, datë 13.3.1996. Ky i fundit nuk është shfuqizuar përderisa vepron për kategoritë e ushtarakëve të Ministrisë së Brendshme e të Shërbimit Informativ të Shtetit.

- Aplikimi i fuqisë prapavepruese të ligjit objekt shqyrtimi përbën vetëm një rast të veçantë për kategori të veçanta njerëzish dhe për lehtësimin e reformës që po kryhet në Forcat e Armatosura.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kujtim Puto, përfaqësuesin e kërkuesit, të subjekteve të interesuara dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me ligjin nr.9481, datë 16.2.2006, ka bërë disa ndryshime e shtesa në ligjin nr.9418, datë 20.5.2005 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë". Në ndryshim nga ligji i vitit 2005, neni 1 i ligjit objekt shqyrtimi i ndan në dy kategori ushtarakët e shërbimit aktiv të përhershëm për efekt të përfitimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi: në ushtarakë që kanë dalë në pension deri në 29.4.2004 (data e hyrjes në fuqi të ligjit nr.2910, datë 23.3.2004 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë") dhe në ushtarakë që kanë dalë në pension pas datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji. Për të dyja këto kategori, ligji i ndryshuar, ashtu edhe ai i mëparshëm u njeh të gjithë ushtarakëve të drejtën e përfitimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi në masën 50 për qind të pagës referuese, duke shtuar 2 për qind të kësaj page për çdo vit vjetërsie në shërbim mbi vjetërsinë prej 15 vjet për meshkujt e 12 vjet për femrat. Por përsa i përket maksimumit të kësaj pagese ligji i ri bën ndryshime esenciale në raport me ligjin nr.9418, datë 20.5.2005. Ndërsa me ligjin e mëparshëm pagesa e pensionit shkonte deri në katërfishin e pensionit bazë në shkallë vendi, me ligjin e ri ulet pagesa e pensionit të parakohshëm për ushtarakët e dalë në pension deri në datën e hyrjes në fuqi të ligjit për statusin. Për këta ushtarakë kjo pagesë shkon deri në masën e pensionit maksimal në shkallë vendi, e barabartë me dyfishin e pensionit bazë. Përsa i përket ushtarakëve të dalë në pension të parakohshëm pas hyrjes në fuqi të ligjit për statusin, maksimumi i pagesës jepet i diferencuar sipas gradës dhe shumë më i favorshëm nga ajo që u jepet ushtarakëve që kanë dalë në pension para ligjit për statusin.

Neni 2 i ligjit objekt shqyrtimi, interpretuar në lidhje me nenin 1 paragrafi i dytë i tij, nuk lejon që ushtarakëve, të cilët kanë dalë në pension deri në ditën e hyrjes në fuqi të statusit, t'u jepet pension i parakohshëm kur ata punësohen, ndërsa u njeh të drejtën për pension të parakohshëm, edhe nëse punësohen, ushtarakëve që kanë dalë në pension pas hyrjes në fuqi të ligjit për statusin, në varësi të vendit të ri të punës: kur punësohen në sektorin publik marrin sa një pension bazë në shkallë vendi, ndërsa kur punësohen në vende të tjera pune masa e përfitimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi do të jetë deri në kompensimin e pagës referuese duke vënë edhe një kufi maksimal sipas gradës së secilit ushtarak. Në këtë mënyrë, ndryshimet që kundërshtohen i kthejnë ushtarakët, që kanë dalë në pension para hyrjes në fuqi të ligjit për statusin, në situatën juridike të ligjit të vitit 1996 me ndryshimet e vitit 1999, në bazë të të cilave ushtarakët që punësohen nuk gëzojnë të drejtën për pension të parakohshëm.

Kërkuesit kanë kundërshtuar gjithashtu përmbajtjen e nenit 7 të ligjit të ri, me të cilin është bërë shtesë në nenin 31 të ligjit të vitit 2005. Sipas shtesës, periudha 1.10.1993 - 31.12.1998 u njihet ushtarakëve si periudhë sigurimi për efekt të pensionit të pleqërisë kur ata plotësojnë kushtet për këtë pension, duke i ndarë në dy kategori: në ushtarakë që kanë përfituar pension të parakohshëm ngaqë e kishin vjetërsinë si

ushtarakë, të cilëve do t'u derdhet kontribut për aq vite sa u nevojiten për efekt të përfitimit të pensionit të plotë të pleqërisë, dhe në ushtarakë që nuk kanë përfituar pension të parakohshëm ngaqë nuk e kishin vjetërsinë si ushtarakë, të cilëve kontributi në sigurimet shoqërore nuk u derdhet për gjithë periudhën 1993-1998, por vetëm për dy vjet për burrat dhe tre vjet për gratë. Me shtesën e bërë, kontributi që do të derdhet nga Buxheti i Shtetit në sigurimet shoqërore për këtë periudhë bëhet mbi bazën e pagës minimale në shkallë vendi dhe jo sipas pagës referuese siç ka qenë miratuar me ligjin e vitit 2005.

Duke shqyrtuar përmbajtjen e ndryshimeve e shtesave ligjore në raport me pretendimet e palëve ndërgjyqëse, Gjykata Kushtetuese arriti në përfundimin se ato nuk janë në përputhje me parimet kushtetuese.

E drejta për pension është një e drejtë që përfshihet në grupin e të drejtave ekonomike-sociale, që për nga natyra janë të drejta pozitive. Prandaj, përmbajtja e tyre duhet interpretuar në lidhje të ngushtë me detyrimin e shtetit për t'u bërë aktiv e për t'u garantuar shtetasve sigurimin e mjeteve të përshtatshme për nevojat jetësore në rastet e fatkeqësive, sëmundjeve, invaliditetit, pleqërisë dhe papunësisë së padëshiruar. Këto mangësi shteti duhet t'i garantojë pa lejuar diskriminim të paarsyeshëm e jo objektiv.

Parimi i barazisë, i parashikuar në nenin 18 të Kushtetutës, kërkon që të gjithë qytetarët të jenë të barabartë përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore. Nga ana tjetër, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, duke sanksionuar parimin e barazisë para ligjit, nuk i ka dhënë asaj kuptimin e një të drejte absolute, sepse ajo ka përcaktuar njëkohësisht edhe kushtet e kufizimit në ushtrimin e kësaj të drejtë. Paragrafi i tretë i nenit 18 të Kushtetutës pranon kufizimet e të drejtës për barazi me përmbushjen e disa kushteve të posaçme, pikërisht të përligjjes së arsyeshme dhe objektive.

Respektimi i parimit të barazisë kërkon ndërmjet të tjerave mosdiskriminimin e grupeve në kushte të njëjta të shtetasve pa arsye të përligjura. Ky parim kërkon që të gjitha subjektet të trajtohen në mënyrë të njëjtë, por nuk formulon ndalime që të mund të bëhet trajtim i diferencuar kur individët e grupet nuk ndodhen në kushte të njëjta apo të ngjashme apo kur ka justifikim të arsyeshëm e objektiv, duke vendosur një raport të arsyeshëm dhe përpjesëtimor midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet.

Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se dallimi në trajtim do të konsiderohet diskriminues, në vështrim të standardeve të nenit 14 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, kur ai "... nuk ka justifikim të arsyeshëm e objektiv", pra kur ai nuk ndjek një "qëllim të ligjshëm" ose kur nuk ekziston "...marrëdhënie e arsyeshme dhe përpjesëtimore ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet". Në çështjen në shqyrtim, subjekti i interesuar pretendoi se interesi publik është ai i pakësimit të shpenzimeve shtetërore. Mirëpo, qëllimi që synohet të arrihet me anë të këtij pakësimi passjell jo vetëm dëmtimin e një kategorie ushtarakësh (ata që kanë dalë në pension para hyrjes në fuqi të ligjit për statusin), por edhe vendosjen e kësaj kategorie në një trajtim diskriminues pa justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, me qenë se kjo ndarje nuk bazohet në vitet e shërbimit, në moshën, pagën referuese e gradën siç përcaktohen këto në nenet 7 e 8 të pandryshuara të ligjit nr.9418, datë 20.5.2005. Për më tepër, duke marrë në konsideratë kushtet në të cilat kjo kategori ushtarakësh del në pension të parakohshëm, si mosha relativisht e madhe e profesioni si ushtarak, ajo e ka të vështirë jo vetëm kualifikimin në një profesion të ndryshëm nga ai ushtarak, por edhe punësimin.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në jurisprudencën e saj[1] lidhur me mbrojtjen kushtetuese të parimit të barazisë e të mosdiskriminimit, është shprehur se barazia në ligj dhe para ligjit nuk parakupton zgjidhje të njëllojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme, por ajo parakupton kryesisht barazinë e individëve që ndodhen në kushte të njëllojta. Në rastin në gjykim, bëhet fjalë për individë që ndodhen në kushte të njëjta. Mirëpo, ligji objekt shqyrtimi nr.9481, datë 16.2.2006 i ka ndarë këta individë në dy kategori, përkatësisht në kategoritë e ushtarakëve rezervë/lirim para dhe pas hyrjes në fuqi të Statusit të Ushtarakut, gjë që krijon artificialisht dallim jo të papërfillshëm ndërmjet tyre në masën e pensionit të parakohshëm që ata përfitojnë deri në daljen e tyre në pension.

Në nenin 5 të ligjit nr.9210, datë 23.3.2004 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të cilit i referohet ligji në shqyrtim, pasi pranohet karakteri i veçantë i detyrës dhe i shërbimit ushtarak, pranohet se si ushtarakët efektivë, ashtu edhe ata në rezervë/lirim ose në pension gëzojnë në mënyrë të njëllojtë statusin si ushtarak dhe, parimisht, nuk lihet vend për krijimin e ndonjë ndarjeje midis këtyre kategorive.

Në çështjen në shqyrtim, ku pretendohet mosrespektimi i parimit të barazisë, merr rëndësi të veçantë trajtimi i dispozitave ligjore në dritën e parimeve të tilla, si shteti social dhe shteti i së drejtës. Këto

[1] Shih vendimin nr.11, datë 27.8.1993 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

parime kërkojnë që shteti, si rregullator, të vendosë kufijtë midis të mirës së përgjithshme të shoqërisë dhe të drejtave të grupeve të veçanta. Shteti duhet të niset nga trajtimi i barabartë për të gjithë dhe pastaj të kujdeset përkatësisht për kriteret e secilit grup. Ligjvënësi duhet të çmojë vetë, sipas përparësive që ai ka vendosur për zhvillimin ekonomik e shoqëror, se cilat janë format më të përshtatshme për balancimin e interesave, duke bërë edhe diferencimet e arsyeshme, pa cenuar parimet dhe normat kushtetuese. Në rastin e dhënë, ligjvënësi u ka caktuar ushtarakëve pagesë pensioni të diferencuar, duke i ndarë ata në dy kategori. Si kufij ndarës midis grupeve, ai ka përcaktuar datën e hyrjes në fuqi të ligjit nr.9210, datë 23.3.2004 "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë". Mirëpo, një diferencim i tillë nuk ka sesi të përligjet me ndarjen kohore, sepse vetëm data e daljes në pension nuk mund të përbëjë kriter objektiv dhe të arsyeshëm që do të justifikonte diskriminimin.

Për të rrëzuar argumentimin e kërkuesit, që ka të bëjë me treguesin kohor, subjektet e interesuara i referohen vendimit nr.43 datë 25.8.1997 të Gjykatës Kushtetuese, në të cilin kjo e fundit ka pranuar se nuk është shkelur parimi i barazisë në ligjin nr.7496, datë 3.7.1991 "Për statusin e ushtarakut në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", që u jepte shpërblime shoqërore suplementare ushtarakëve vetëm për periudhën pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Ndryshe nga pretendimi i subjekteve të interesuara, sipas të cilëve, se kërkesa përbën çështje të gjykuar, Gjykata Kushtetuese ka pranuar, në këtë vendim, se ligji i kundërshtuar është "... nxjerrë jo për të bërë dallime ndërmjet ushtarakëve që kanë shërbyer para dhe pas vitit 1991, por për të siguruar funksionimin e rregullt të Forcave të Armatosura në kushtet e reja ekonomiko-shoqërore të sistemit të ekonomisë së tregut [1]". Dallimi i periudhave që karakterizohet nga kërkesat cilësisht të reja dhe nga ndryshimi i kushteve të jetesës ishte mjaft thelbësor dhe ai mund të shërbente si kriter ndarjeje midis ushtarakëve. Mirëpo, ky dallim periudhash nuk është i njëjtë me atë që ka përcaktuar ligjvënësi në ligjin objekt shqyrtimi, sepse kushtet ekonomike-shoqërore dhe ato të tregut kanë mbetur afërsisht të njëjta, ato nuk karakterizohen me ndonjë ndryshim thelbësor. Në një shtet të së drejtës, zhvillimi dhe evoluimi i vazhdueshëm i Forcave të Armatosura nuk mund të shërbejë si kriter për të përligjur diferencime, të mbështetur në kohën e daljes në pension, për caktimin e pensionit të ushtarakëve; një kriter i tillë nuk është as i arsyeshëm dhe as objektiv.

Ligji që kundërshtohet u ka dhënë të drejtën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi në rast punësimi vetëm ushtarakëve që dalin në lirim ose rezervë pas miratimit të statusit të ushtarakut, ndërsa për ata ushtarakë që kanë dalë para statusit zbatohen dispozitat e ligjeve të viteve 1996 e 1999, sipas të cilave ushtarakët që punësohen nuk gëzojnë të drejtën për të marrë pension të parakohshëm. Një qëndrim i tillë nuk përligjet me kritere të arsyeshme dhe objektive, sepse nuk mund të kushtëzohet e drejta për t'u punësuar me datën e daljes në pension të parakohshëm. Kështu, dy kategoritë e ushtarakëve në rezervë/lirim që ndodhen në kushte të njëjta, pra të punësuar pas daljes në rezervë/lirim, diskriminohen midis tyre sipas një treguesi që nuk përbën kriter të arsyeshëm dhe objektiv.

Për të shfuqizuar si antikushtetues ligjin objekt shqyrtimi, kërkuesi nxjerr si argument, ndër të tjera, edhe cenimin e parimit të sigurisë juridike. Si element i shtetit të së drejtës, siguria juridike presupozon veç të tjerave besueshmërinë e qytetarëve te shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë ose për pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme.

Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë i referon te parimi i shtetit të së drejtës konceptin e sigurisë juridike, të së drejtës së fituar, të pritshmërisë së ligjshme dhe të besimit të qytetarëve te shteti, parim që është sanksionuar në neni 4 të Kushtetutës dhe që duhet kuptuar e interpretuar në lidhje të ngushtë me aspiratën e shprehur në Preambulën e Kushtetutës, ku është skalitur vendosmëria e popullit shqiptar "... për të ndërtuar shtetin e së drejtës, demokratik e social. "Shteti i së drejtës, i cili garantohet që në Preambulën e Kushtetutës, është një nga parimet më themelore e më të rëndësishme në shtetin dhe shoqërinë demokratike. Si i tillë, ai përbën një normë të pavarur kushtetuese, prandaj shkelja e tij përbën në vetvete bazë të mjaftueshme për deklarimin e një ligji si antikushtetues".[2]

Duke qenë se një ndër elementet më thelbësore të parimit të shtetit të së drejtës është edhe ai i sigurisë juridike, del se rregullimet ligjore që kanë të bëjnë me të drejtat e shtetasve duhet të kenë qëndrueshmëri të mjaftueshme që siguron vijimësinë e tyre. Si rregull, nuk mund të mohohen interesa dhe pritshmëri të ligjshme të qytetarëve nga ndryshimet në legjislacion dhe shteti duhet të synojë të ndryshojë një situatë të rregulluar më parë vetëm nëse ndryshimi sjell pasoja pozitive, konkretisht trajtim më të mirë

[1] Vendime të Gjykatës Kushtetuese 1997-1999, Tiranë 2000, QPZ, faqe 100.
[2] Vendimi nr.34, datë.20.12.2005 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

financiar për subjektet përfituese. Sanksionimi i të drejtave dhe lirive të njeriut të pranuara në Kushtetutë dhe shoqërimi i tyre me masat për vënien në jetë të tyre duhet të synojnë përmirësimin dhe rritjen e standardeve të të drejtave, forcimin e shtetit ligjor. Nëse masat e marra shpien në përkeqësimin në mënyrë të paarsyeshme të gjendjes ligjore të personave të tjerë, mohojnë të drejtat e fituara ose injorojnë interesat legjitime të këtyre, atëherë do të dhunohet parimi kushtetues i barazisë së të drejtave dhe, në përgjithësi, do të rrezikohet arritja e qëllimit madhor të ndërtimit të shtetit të së drejtës.

E drejta për pension (qoftë edhe për pension të parakohshëm) është e drejtë subjektive. Këto të fundit - marrëdhëniet juridike të krijuara - mbrohen nga parimi kushtetues i shtetit të së drejtës, në të cilin përfshihen edhe e drejta e fituar dhe siguria juridike. Prandaj, futja e një rregullimi të ri për pensionet duhet të bëhet duke u kujdesur që kjo të respektojë, ndër të tjera, edhe këto të fundit.

Ashtu sikundër theksohet edhe në vendimin nr.34 të vitit 2005 të Gjykatës Kushtetuese, siguria juridike nuk mund, megjithatë, të eliminojë çdo pasojë negative që mund t'i vijë individit nga rregullimi i ri, përderisa kjo siguri është e pandashme nga parimi i shtetit social. Prandaj, edhe të drejtat e fituara mund të kufizohen si përjashtim, por kufizime të tilla mund të bëhen duke respektuar parimin e përpjesëtimit në lidhje të ngushtë me parimet e drejtësisë, e paanshmërisë dhe të mirëfunksionimit të shtetit. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata Kushtetuese çmon se ndryshimet e bëra në ligjin nr.9418, datë 20.5.2005 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", nuk kanë respektuar kërkesat kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave të fituara.

Ndryshimet në ligjin objekt shqyrtimi cenojnë pozitën juridike të një kategorie ushtarakësh në pension duke prekur nevojat jetike të tyre. Mbështetur në karakterin e veçantë të detyrës dhe të shërbimit të ushtarakëve, ligjet e mëparshme kishin përcaktuar, për efekt pensioni, një pozitë juridike dhe ekonomiko-financiare më të favorshme se për disa kategori të tjera punonjësish, duke formuluar edhe garancitë ligjore për zbatimin e tyre. Ndërkaq, ishin përcaktuar gjithashtu edhe kriteret e caktimit të pensioneve që merrnin në konsideratë gradën, pagën referuese, vjetërsinë në shërbim si ushtarak etj. Ligji objekt shqyrtimi i ndryshon këto kritere vlerësimi për pensionet, megjithëse kushtet e subjekteve përfituese mbeten të pandryshueshme. Për caktimin e pensionit, ky ligj vendos si kriter datën e daljes në pension të ushtarakut. Ligjet e mëparshme i kanë njohur ushtarakut të drejtën për të gëzuar pension të parakohshëm edhe në rastin kur ai punësohet, ndërsa me ligjin e ri nuk do ta gëzojnë atë ata ushtarakë që kanë dalë në pension para datës 29 prill 2004. Ligji nr.9418, datë 20.5.2005, mbështetur në karakterin e veçantë të detyrës dhe të shërbimit të ushtarakut, kanë fiksuar kriteret e caktimit të masës së pensionit mbi bazën e pagës referuese, nga ku është përcaktuar edhe detyrimi i shtetit për të derdhur, për çdo ushtarak në shërbim, kontribut në sigurimet shoqërore për periudhën 1.10.1993 - 31.12.1998. Ndërsa ligji objekt shqyrtimi ka pakësuar detyrimin e shtetit për kontributin në sigurimet shoqërore, duke e nxjerrë atë mbi bazën e pagës minimale në shkallë vendi, gjë që passjell pakësimin e masës së pensionit për kategorinë përkatëse të ushtarakëve.

Gjykatës Kushtetuese nuk i rezulton se ndryshimet e sipërpërmendura, që ulin ndjeshëm masën e pensionit të një kategorie ushtarakësh, të jenë bërë nga nevoja të domosdoshme publike. Siguria juridike mund të preket kur është fjala për të mbrojtur një interes publik, por në gjykimin e çështjes nuk u paraqitën e nuk u konstatuan shkaqe ose motive që justifikojnë domosdoshmërinë e prishjes së ekuilibrave të vendosura ose rrethana të reja që të bënin të pamundur vlefshmërinë dhe efikasitetin e ligjit të mëparshëm për pensionet dhe të kërkonin marrjen e masave të tjera për të realizuar objektiva ligjërisht të synuara për t'u arritur.

Neni 1 i ligjit objekt shqyrtimi i "kthen" sërish te ligji nr.8087 datë 13.3.1996, me ndryshimet e vitit 1999, ushtarakët e shërbimit aktiv të përhershëm që kanë dalë në rezervë/lirim deri në datën 29 prill 2004 (data e hyrjes në fuqi të ligjit për statusin). Ligji që kundërshtohet ka bërë ndryshimet në nenin 13 të ligjit të vitit 2005, duke përcaktuar që ushtarakët do të përfitojnë pension sipas ligjit të vitit 1996 (të ndryshuar), pra në masë më të vogël, ndërsa ka lënë të pacenuar nenin 33 të po atij ligji. Sipas këtij të fundit, ligji i vitit 1996, për sigurimet shoqërore suplementare të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ të Shtetit, i ndryshuar, pas hyrjes në fuqi të ligjit të vitit 2005, nuk do të zbatohet për ushtarakët e Forcave të Armatosura. Në këtë mënyrë, ndërsa ligji që kundërshtohet i bën referencë ligjit të vitit 1996 për përfitimet e një kategorie ushtarakësh, neni 33 i pandryshuar i ligjit të vitit 2005 ndalon zbatimin e atyre dispozitave, duke krijuar kështu paqartësi në kuptimin e ligjit dhe në zbatimin e tij. Prandaj, e parë edhe në lidhje me pasojat që sjell, kontradikta midis këtyre ligjeve ngrihet në nivelin e shkeljes së parimeve kushtetuese të ligjshmërisë e të sigurisë juridike. Vetë siguria juridike si element i shtetit të së drejtës ka si kërkesë të domosdoshme që ligji në tërësi apo dispozita të veçanta të tij, në përmbajtjen e tyre duhet të jenë të qarta, të përcaktuara dhe të kuptueshme.

Kërkuesi ka kërkuar gjithashtu shfuqizimin si antikushtetues të nenit 9 të ligjit objekt shqyrtimi që

ndryshon datën e hyrjes në fuqi të ligjit të mëparshëm.

Neni 34 i ligjit nr.9418 i vitit 2005, i shpallur me dekretin nr.4623, datë 6.6.2005 të Presidentit të Republikës, parashikon hyrjen në fuqi të tij më 1 janar 2006. Mirëpo, ligji i datës 16.2.2006 që kundërshtohet, megjithëse është botuar në Fletoren Zyrtare më 15.4.2006 dhe ka hyrë në fuqi më 29.4.2006, ka parashikuar, në nenin 9 të tij, që ligji i vitit 2005 nuk hyn në fuqi më 1 janar 2006, por më 16 prill 2006, pra ai ka shtyrë datën e hyrjes në fuqi të ligjit të mëparshëm kur ai kishte hyrë praktikisht si i tillë. Si rregull, ligjet i shtrijnë efektet e tyre për kohën e ardhshme dhe fuqia prapavepruese e tyre zbatohet në raste përjashtimore, sepse në të kundërt mund të krijohen situata me pasoja të paparashikuara. Teoria e së drejtës pranon se fuqia prapavepruese zbatohet si përjashtim si për shembull në ligjet penale favorizuese, në ligjet që ndërhyjnë për të rregulluar me ligj situata të paligjshme të krijuara më parë, në ligjet që interpretojnë anët e errëta ose të paqarta të një ligji të mëparshëm e në ndonjë rast tjetër ku paraqitet domosdoshmëria për të shmangur pasoja të rënda, negative ose të pandreqshme. Në rastin në shqyrtim, nuk ka pasur situata të paligjshme ose të errëta apo me pasoja të tilla kaq të rënda.

Siç kuptohet, ligji objekt shqyrtimi ka pasur efekt prapaveprues mbi një periudhë prej pothuajse 4 muajsh, periudhë gjatë së cilës individët e kategorisë së interesuar për çështjen përfituan një përllogaritje të ndryshme, më të favorshme të pensionit të parakohshëm, pavarësisht nga fakti nëse e gëzuan konkretisht ose jo përfitimin. Me ndryshimin e datës së hyrjes në fuqi, kur ai tashmë kishte hyrë si i tillë, ligji i ri u fut në periudhën kur vepronte ligji i mëparshëm dhe kjo nuk është çështje që ka të bëjë thjesht me "teknikat juridike", por përbën cenim të parimit kushtetues të sigurisë juridike. Në vendimin e saj nr.1, datë 31.1.2003, Gjykata Kushtetuese është shprehur se sa i takon "...nocionit të fuqisë prapavepruese, doktrina ka pranuar se kjo është e pranishme në rastet kur një normë ligjore aplikohet për gjëra tashmë të vendosura në të kaluarën. Në aspektin kushtetues, ligji me fuqi prapavepruese është i kundërshtueshëm në qoftë se cenon të drejtat e fituara me ligjet ekzistuese[1]".

Duke u dhënë akteve fuqi prapavepruese (rëndom dhe jo si përjashtim), sidomos në rastet kur aktet e reja sjellin efekte të pafavorshme për subjektet që preken prej tij, do të cenohet parimi i sigurisë juridike dhe, rrjedhimisht, do të shkelet parimi i shtetit të së drejtës. Edhe për çështjen në shqyrtim, dhënia e fuqisë prapavepruese për ligjin ka cenuar sigurinë juridike dhe të drejtat e fituara, sepse ka ulur masën e pensioneve në raport me ligjin e mëparshëm. Cenimi i parimit të sigurisë juridike bëhet veçanërisht më i ndjeshëm në marrëdhëniet e sigurimeve shoqërore të disa kategorive punonjësish (p.sh. të ushtarakëve), me qenë se kjo marrëdhënie mbështetet në strukturën ligjore të mbajtjes së besimit dhe në bindjen e të siguruarve për seriozitetin dhe korrektësinë e shtetit.

Për sa më sipër, Gjykata Kushtetuese arriti në përfundimin se duhet pranuar kërkesa e Shoqatës Kombëtare të Ushtarakëve në Rezervë të Shqipërisë për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të neneve 1, 7 (shkronjat "a, b") dhe 9 të ligjit nr.9481, datë 16.2.2006 "Për disa ndryshime në ligjin nr.9418, datë 20.5.2005 "Për sigurimet shoqërore suplementare të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë". Meqenëse me shfuqizimin e këtyre dispozitave krijohen boshllëqe lidhur me pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi dhe për pensionet e pleqërisë të ushtarakëve, bazuar në ligjin nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i rekomandohet Këshillit të Ministrave e Kuvendit të Shqipërisë të marrin masa për të bërë rishikimin në tërësi të ligjit në përputhje me këtë vendim të Gjykatës Kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 51, 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të neneve 1, 7 (shkronjat "a", "b") e 9 të ligjit nr.9481, datë 16.2.2006 "Për disa ndryshime në ligjin nr.9418, datë 20.5.2005 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë"".

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

[1] Vendime të Gjykatës Kushtetuese të vitit 2003, Tiranë-2004, faqe 11.